



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr 409 prot

Vlorë më 05/3 /2020

Vendim

Nr 3 datë 26.02 2020

PËR

NDRYSHIM NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT TË VITIT 2020,
MIRATUAR ME VKQ NR 14 DT.27.12.2019

Këshilli i Qarkut Vlorë pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur, nga grupi i punës për ndryshim brenda buxhetit të Këshillit të Qarkut të vitit 2020, mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore " neni 8 pika 2 neni 9 pika 1.1, b neni 31 pika 1.2.3 neni 34, neni 38, neni 40, neni 41 , neni 72 pika 5, neni 77 pika dh, neni 83, pika ç.
- Ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 40 .
- Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
- Ligjin nr. " për buxhetin e vitit 2020", neni 16.
- Ligjin nr. 137/2016 "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Komisionit European për programin INTERREG IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri, 2014-2020.
- V.K.M. nr. 783 dt. 09.11.2016 "Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Republikës së Greqisë dhe Komisionit European për programin INTERREG IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Greqi-Shqipëri, 2014-2020"
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit".
- "Udhëzimi plotësues i Ministrisë së Financave nr.2. datë 20.01.2020 " Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020".

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshim brënda buxhetit të vitit 2020 tek të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2020 në lekë, si më poshtë:

a). Të miratojë pakësimin e fondeve të të ardhurave të veta kapitull 5 (pesë), të shtohen në kapitull 2 (dy) për performancë Projekte me BE në vlerë. **1.355.000**

b). Të miratojë pakësimi fondi prej **2.768.000** lekë për shpenzime te Gërma B pika (1) gërma (h) art 231 (kap 1), (Investime) dhe ta shtojë këtë fond te Gërma B pika (1) gërma (j) Art 604 (Investime Transferim Bashkive)

c). Të miratojë pakësimi fondi prej **1.355.000** lekë për shpenzime te Gërma B pika (2) gërma (b) art 230 (kap 5), (Promovim i kulturës dhe trashëgimisë kulturore) dhe ta shtojë këtë fond për shpenzim te Gërma B pika (3) gërma (a) shpenzime indirekte, art 602 kap (2) (për performancë Projektesh) Rialokim fonde pasi të jetë kryer shpenzimi dhe të jetë vlersuar performanca e projekteve) skemën e financimit të projekteve nga donatori me disbursim, për projektin Adrinet.

2. Shpenzimet e germës B/ pika 1,2,3 do të do të përdoren sipas pasqyrës bashkëlidhur.

3. Shpenzimet për investime të germës B, sipas pikës 1 gërma (h), pika 2 gërma (c) pika 3 gërma (b) do të përdoren në objektet e mëposhtme:

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtori Ekonomik dhe grupet e punës të caktuar për projektet me financim të huaj.

5. Kryetari i Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë transferimin e fondeve operative pa limit për artikujt e miratuar nga Këshilli i Qarkut brënda Institucionit.

6. Drejtori Ekonomik pranë Këshillit të Qarkut autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuar nga Këshilli i Qarkut sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financave për çdo muaj.

7. Ky vendim hyn në fuqi sipas **ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore"**.